



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 78-të, të mbajtur më 24.11.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi me numër 12-5566/1 i datës 03.06.2022, HIDHET POSHT.

KSHPK-ja konstatoi se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm ndaj lëndës.

Denoncimi me provat duhet t'i përcillet Ministrisë së Punëve të Brendshme të RMV-së për veprime kompetente.

Lënda me numër 12-5566 të vitit 2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-5566/1 të datës 03.06.2022 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen keqpërdorimeve financiare në ///. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, u dorëzuan edhe prova.

Nga mbikëqyrja në përmbajtjen e denoncimit dhe provave të dorëzuara, KSHPK-ja vlerësoi se lënda nuk elemente për veprim kompetent. Kjo për faktin se drejtuesit e shoqatës së lartpërmendur nuk kanë statusin e zyrtarit në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit. Autoriteti kompetent i cili me ligj është i autorizuar për të hetuar pretendimet në denoncim është Ministria e Punëve të Brendshme e RMV-së, për çka KSHPK-ja e konsideroi të nevojshme që denoncimin me provat t'ia përcjellë këtij autoriteti për veprim kompetent.

Bazuar në të theksuarën sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar deri:
Parashtruesi

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi: Mr.Sh. S.

КОМИСИОНИ ШТЕТЁРОРЁ
ПЁР ПАРАНДАЛИМИН Е КОРРУПСИОНИТ
КРЈЕТАРЕ,
Biljana Ivanovska

